


	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatorin Ekonomik: “IZO – H” Sh.p.k. me adresë në Prishtinë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi – U.d. Menaxher i Prokurimit – Komuna e Rahovecit 
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	23.08.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për ri-shqyrtim** të datës: 23.08.2019, të parashtruar nga Operatorin Ekonomik: “IZO – H” Sh.p.k. me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **MEREMETIMI DHE LYERJA E SHKOLLËS FILLORE “HAMËZ THAQI” NË XËRXË**, me Numër të prokurimit: 623-19-5777-5-3-6, Nr i brendshëm: 623-19-051-5-3-6, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatorin Ekonomik: “IZO – H” Sh.p.k. me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **MEREMETIMI DHE LYERJA E SHKOLLËS FILLORE “HAMËZ THAQI” NË XËRXË**, me Numër të prokurimit: 623-19-5777-5-3-6, Nr i brendshëm: 623-19-051-5-3-6, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: 22.08.2019, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autorteti Kontraktues vendos të vazhdoj Vendimin e miratuar nga Autoriteti Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **MEREMETIMI DHE LYERJA E SHKOLLËS FILLORE “HAMËZ THAQI” NË XËRXË**, me Numër të prokurimit: 623-19-5777-5-3-6, Nr i brendshëm: 623-19-051-5-3-6, dhe mbështetë Vendimin e miratuar nga Autoriteti Kontraktues.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatorin Ekonomik: “IZO – H” Sh.p.k. me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **MEREMETIMI DHE LYERJA E SHKOLLËS FILLORE “HAMËZ THAQI” NË XËRXË**, me Numër të prokurimit: 623-19-5777-5-3-6, Nr i brendshëm: 623-19-051-5-3-6, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: 22.08.2019, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 23.08.2019, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Pretendimet e Operatori Ekonomik:

Ne dosje te tenderit nuk keni kerkuar te plotsohet Seksioni II: Fleta e te dhenava te Tenderit(FDT). Si e tille nuk mund te mirret si kriter per vleresim te ofertes.

“II.5 Vendi për ekzekutimin e punëve është: **NË XËRXË**.”

Operatori Ekonomik është i obliguar të paraqesë planin dinamik i detalizuar sipas pozicioneve të paramasës, duhet të dorëzohet në origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga Operator Ekonomik. “

Kushtet administrative apo te pershtatshmerise kerkohen qartas, nuk nenkuptohen dhe sqarohen pas njoftimit per vendim te autoritetit kontraktues.

Ju keni kerkuar plan dinamik.

Ne planin dinamik ju kemi nenshkruar e vulosur me dinamik te punimeve mbrenda afateve qe keni kerkuar.

Ju keni shkelur dispozitat ligjore te KRPP-s.

Ju keni kerkuar plan dinamik.

Ne planin dinamik ju kemi nenshkruar e vulosur me dinamik te punimeve mbrenda afateve qe keni kerkuar.

Na keni aryetuar se me pozicione te detalizuar. Qka kuptoni ju me “detalizuar”?

Ne Seksionin II eshte tabela me pozicione dhe qmime, qe eshte e njejta gje sikurse paramasa. Nuk ka plan te detalizuar aty as kohor apo pozicionesh.

Plani real dinamik behet ne fillim te punimeve ne koordinim me menaxherin e

3/3

kontrates, duke ju pershtatur orarit te vendpunimit, siq eshte shkolla ne kete rast. Qfar problemi administrativ apo te pershtatshmerise paraqet ky kriter i “zbuluar” nga ju ne drejtim te permbushjes se kontrates?

Kjo eshte thjesht gracke gjuhesore ndaj operatoreve ekonomik me tendenca per manipulime. Kjo oshte fytyre e intelegjences per operator ekonomik nga ana juaj.

Kerkoj reflektim dhe rivlersim korrekt nga ju, ose ate do ta bejne institucionet tjera kompetente.

Baza Ligjore për refuzim të kërkesës

Përgjigje nga AK: Tek Letër standarde për tenderuesin e eliminuar, ju është dhënë arsyejt看im se pse tenderi juaj është eliminuar.

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, sipas Dosjes së tenderit te Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT): Neni II – Qëllimi i Kontratës, paragrafi – II.5:

II.5 Vendi për ekzekutimin e punëve është: NË XËRXË,
Operatori Ekonomik është i obliguar të paraqesë planin dinamik i detalizuar sipas pozicioneve të paramasës, duhet të dorëzohet në origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga Operator Ekonomik.

Ju si Operator Ekonomik, keni prezantuar nje plan dinamik, por qe NUK eshte sipas kerkeses se A.K. Komunes se Rahovecit.

Kerkesa e A.K – Komuna e Rahovecit, ka bere kerkes shum te kjarnte se plani dinamik duhet te dorezohet i detalizuar sipas pozicioneve te paramasës, d.m.th. per çdo pozicon te paramasës është kërkuar plani dinamik, kurse ju si si O.E. keni dorëzuar një plane dinamik qe nuk i permbush as kerkesa minimale te A.K Komuna e Rahovecit.

Kjo procedurë eshte trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Kundër ketij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Astrit Mullabazi
U.d. Menaxher i Zyres se Prokurimit
Komuna e Rahovecit